Bashkia Pogradec

# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

## Bashkia Pogradec



# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
# Bashkia Pogradec

Pogradec, 2005

**Përgatitja e këtij dokumenti është financuar nga:**

**Swedish International Development Cooperation Agency (SIDA)**

*Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk paraqesin domosdoshmërisht opinionet e Sida. Përgjegjësia për to mbetet e e autorit.*

**Me mbështetjen e:**

**Qendra Rajonale e Mjedisit**

*për Evropën Qendrore dhe Lindore*

**Zyra në Shqipëri**

**Rreth REC**

**Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)**
*për Evropën Qendrore dhe Lindore*
**Zyra në Shqipëri**
është një organizatë ndërkombëtare jopartizane, joavokate, jofitimprurëse që mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore. REC është krijuar në 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Sot REC, bazohet ligjërisht në Kartën e tij, nënshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve në secilin prej 15 vendeve përfituese.

Shqipëria e ka nënshkruar Kartën e REC në 1993. Zyra e REC për Shqipërinë është hapur në 1994. Kjo zyrë punon për realizimin e misionit të REC duke mbështetur organizatat jofitimprurëse, institucionet mjedisore në të gjitha nivelet, dhe aktorë të tjerë të interesuar në fushën e mjedisit, duke mbështetur proceset pjesëmarrëse e shkëmbimin e lirë të informacionit. Fushat kryesore të veprimtarisë janë: Programi i granteve për OJF-të; Planet Lokale të Veprimit në Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit për OJF-të dhe zyrtarë të mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Donatorët më të fundit janë: Komisioni Evropian, Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, SIDA, UNDP, GEF/SGP, Fondacioni SOROS, SDC, etj.

Adresa: Rr. e Durrësit, P.11, Shk. 2, Ap. 12, Tiranë
Tel/Faks: +355 4 239 444
E-mail: rec@albania.rec.org
Adresa e internetit: http://albania.rec.org

Design: Eduart Cani; Shtypi: Gent Grafik

# Parathënie

*Periudha e zhvillimeve demokratike e gjeti qytetin e Pogradecit si një nga qytetet e "mbrojtur" dhe të mirëmbajtur në aspektin e mbrojtjes së mjedisit dhe me pak pasoja të ndotjes së tij. Lëvizja demografike e popullsisë, në përgjithësi e pakontrolluar dhe e paadministruar si duhet, qoftë për shkak të kapaciteteve, por edhe për shkak të angazhimit të pakët të strukturave qeveritare dhe joqeveritare, solli pasoja të dukshme, si në aspekte të tjera, ashtu dhe në ato mjedisore. Ndërtimet e shumta pa kriter, shtimi i popullsisë dhe i konsumit, mungesa e standarteve dhe institucioneve mjedisore, mungesa e kulturës mjedisore dhe faktorë të tjerë të lidhur direkt ose indirekt me mjedisin, kanë shkaktuar dëme me pasoja të ndjeshme në faktorët mjedisorë, tashmë shqetësuese jo vetëm për strukturat menaxhuese për qytetin, por edhe vetë për qytetarët.*

*Mesa dukej do duhej që ndotja mjedisore të arrinte nivele të larta, për të vënë në alarm të gjitha strukturat dhe të ndërgjegjësonte opinionin publik, për të menduar seriozisht për aspektet mjedisore si dhe për marrjen në konsideratë të efekteve mjedisore në të gjitha vendimet dhe sipërmarrjet.*

*Sot ka një frymë pozitive dhe një ndërgjegjësim në rritje për aspektet mjedisore dhe Institucionet përgjegjëse, midis të cilave dhe Bashkia Pogradec, po punojnë për sigurimin e investimeve të nevojshme për përmirësimin e situatës.*

*Jeta dhe zhvillimi i Pogradecit janë të lidhura ngushtë me turizmin, i cili nuk mund të konceptohet pa një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Projektet dhe investimet e siguruara për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, për ujësjellës kanalizimet e qytetit, për trajtimin e mbetjeve organike dhe joorganike, për gjelbërimin etj., parashikimi dhe realizimi i investimeve duke marrë në konsideratë kushtet urbane dhe mjedisore, synojnë përmirësimin e situatës dhe rikthimin e qytetit në një qytet të standarteve mjedisore të pranueshme, si bazë për zhvillimin e tij të qëndrueshëm.*

*Plani Lokal i Veprimit në Mjedis i shërben këtij qëllimi dhe gjej rastin të falenderoj Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC), për asistencën dhe mbështetjen aq me vlerë në hartimin e një plani strategjik të nevojshëm për Pogradecin dhe Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për financimin e kësaj nisme.*

***Z. Artan Shkëmbi***
*Kryetari i Bashkisë Pogradec*

# Përmbajtja


**Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis ................ 9**
**Vizioni i qytetit të Pogradecit ........................................................ 11**
**Hyrje ........................................................................................13**
**I. Vlerësim i situatës mjedisore në qytetin e Pogradecit ................ 14**
1.1 Gjendja teknike e rrjetit rrugor, shesheve, trotuareve
1.2 Rrjeti i kanalizimeve
1.3 Sistemi i shpërndarjes
1.4 Largimi i ujrave të zeza dhe mirëmbajtja e qytetit
1.5 Gjendja e ajrit, mjedisit, mbetjeve urbane
1.6 Ndotja nga automjetet
1.7 Mbetjet urbane
1.8 Gjendja e lumenjve të qytetit
1.9 Gjelbërimi
1.10 Gjendja e lulishteve në qytet
1.11 Gjendja e gjelbërimit të blloqeve të qytetit
1.12 Energjia
1.13 Ndriçimi publik në qytet
1.14 Mundësitë për futjen e burimeve të reja të energjisë
1.15 Vlerësimi i dëmtimeve në sistemin elektrik – efiçenca e energjisë

**II. Burimet natyrore dhe zhvillimi i turizmit .................................. 21**
2.1 Gjendja
2.2 Politika e zhvillimit të turizmit
2.3 Liqeni i Ohrit
2.3.1 Gjeografia
2.3.2 Hidrologjia
2.3.3 Biodiversiteti dhe burimet natyrore
2.3.4 Fauna dhe flora e liqenit
2.3.5 Mjedisi fiziko-kimik dhe cilësia e ujit të Liqenit të Ohrit

**III. Trashëgimia kulturore .............................................................25**

**Problemet mjedisore .......................................................................27**

**Plani i Aktiviteteve .......................................................................39**

# Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Qytetin e Pogradecit, u hartua përgjatë një periudhe një vejcare dhe në hartimin e tij u përfashinë të gjithë aktorët vendore dhe komuniteti i qytetit.
Si bazë për hartimin e këij plani mjedisor, është përdor PLVM i përgatitur më parë nga Instituti për Zhvillimin e Komunitetit. Për këtë u ngrit një grup pune më specialistë të fushave të ndryshme (urbanistikë, turizëm, shëndetësi, arsim, zonat e gjelbra, trashëgimi kulturore, etj), të cilat punuan në bashkëpunim me specilaistë të tjerë të qytetit për hartimin e PLVM.
Për të pasur një përtfshirje sa më të gjërë dhe për të thither mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar një sërë takimesh me OJFtë vendase dhe me takime publike gjatë të cilëve janë paraqitur gjetjet e grupit të punës dhe janë dikutuar problemet mjedisore të qytetit të Pogradecit.
Një vëmendje e vecantë i është kushtuar rolit të gruas në proceset e përgatitjes dhe zbatimit të politikave dhe planeve të zhvillimit, në kuadër të të cilës janë organizaur takime specifike me gra profesioniste dhe banore të thjeshta të qytetit mbi opinionet dhe kontributin e tyre në këtë plan mjedisor.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis do ti shërbejë Bashkisë Pogradec si dokument pune për hartimin dhe planifikimin e nismave mjedisore në qytetin e Pogradecit. Dokumenti i është paraqitur Këshillit Bashkiak të Qytetit të Pogradecit dhe është miratuar prej tij më 03/06/2005, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune.
Për të ndihmuar këtë proces Plani është i shoqëruar me një shumë investimesh të akorduara nga projekti.

Dokumenti është i hartuar në tre pjesë, në:

### i) analizën e situatës

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha cështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo aanalizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë qytetin e Pogradecit

### ii) listën e problemeve mjedisore

Problemet mjedisore, paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë indikatorët për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

### iii) planin e veprimeve për zgjidhje

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të gjetura. Kjo matricë i shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe sigurimin e fondeve nga donatorët.

## Hapat e hartimit

| | |
|---|---|
| Marrja e angazhimit nga Bashkia Pogradec | Mars 2004 |
| Takim i hapur për fillimin e punës | Prill 2004 |
| Ngritja e grupit të punës me ekspertë lokalë | Maj 2004 |
| Trajnimi i grupit të punës | Maj 2004 |
| Faza e parë e projektit - Analiza e situatës mjedisore | Qershor – Shtator 2004 |
| Faza e dytë e projektit - Përgatitja e listës së problemeve | Tetor – Nentor 2004 |
| Takime me OJQtë mjeidsore dhe të grave në qytet | Dhjetor 2004 |
| Faza e tretë e projektit - Përgatitja e planit të veprimeve | Dhjetor 2004 – Janar 2005 |
| Takime me OJQtë mjedisore dhe të grave në qytet | Shkurt 2005 |
| Takim i hapur në Bashkinë Pogradec për draft materialin | Mars 2005 |
| Finalizimi i dokumentit | Prill 2005 |
| Miratimi i Planit nga Këshilli Bashkiak | 03 Qershor 2005 |





## Vizioni i qytetit të Pogradecit

**Të transformojmë Pogradecin në një vend të këndshëm për të punuar, jetuar dhe vizituar, duke ruajtur vlerat ekzistuese të natyrës, duke iu afruar, më shumë në të gjitha aspektet, traditës së komunitetit, si faktorë që sjellin rivlerësimin e komunitetit dhe konsolidimin e banorëve tanë.**

(Shënim: Marrë nga dokumenti "Plani Strategjik për Zhvillimin Ekonomik", Qyteti i Pogradecit, 2000)

# Pozicioni gjeografik i qytetit të Pogradecit








## Pashaporta e qytetit

| | |
|---|---|
| **Emri** | *Pogradec* |
| **Mosha** | *Shenjat e para shek. V p.e.r.* |
| **Pozicioni gjeografik** | *Në jugindje të Shqipërisë* |
| **Sipërfaqja** | *233,4 ha* |
| **Popullsia** | *38000 banorë* |
| **Lartësia** | *+ 696 m mbi nivelin e detit* |

# Hyrje

## Pozita gjeografike

Pogradeci gjendet në zonën lindore të vendit dhe në pjesën jugperëndimore të Liqenit të Ohrit. Ai shtrihet në 20 38'48" gjatësi gjeografike lindore, 40 54'05" gjerësi gjeografike veriore dhe në kuotën 696 m mbi nivelin e detit.
Kufizohet në veri dhe verilindje me Liqenin e Ohrit, në jug dhe perëndim e rrethojnë, si kurorë, kodra dhe male të lartë, mbuluar me gështenja, ahe dhe dushk, që janë vazhdim i maleve të Mokrës. Në lindje, 5 km larg ndodhet Driloni. Në juglindje kufizohet nga komuna e Buçimasit dhe në veriperëndim nga komuna e Hudënishtit.
Qyteti, duke përjashtuar zonën ekonomike, ndërtimet e parregullta në fushën e Buçimasit dhe ato të zonës periferike përgjatë rrugës kombëtare Pogradec-Korçë, shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme rreth 233,4 ha.

## Kushtet klimaterike

Rajoni i Liqenit të Ohrit ka klimë lokale kontinentale. Temperatura mesatare është 11,4 C, me temparatura mujore maksimale mesatare, në korrik-gusht, prej 21,2 - 34,4 C, temperatura minimale mesatare mujore, në janar, 1,5 C. Minimumi absolut ka arritur në –17,2 C. Reshjet mesatare vjetore janë regjistruar 734 mm në Pogradec dhe 759 mm përreth liqenit. Përsa i përket erërave, drejtimi më i shpeshtë i tyre është nga ana e veriut, sidomos gjatë periudhës së vjeshtës dhe dimrit. Në pranverë dhe verë mbizotërojnë erërat e jugut dhe jugperëndimit. Erërat e lindjes dhe të juglindjes janë të papërfillshme (4-5% e shpeshtësisë së përgjithshme të erës). Shpejtësia mesatare e erës, në rajonin e Liqenit të Ohrit, është 3,4 m/sek.

## Të dhënat demografike

Qyteti i Pogradecit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, si pasojë e ndryshimeve politiko-ekonomike në vend. Popullsia në qytet është rritur si pasojë e ardhjeve të shumta nga zonat rurale, duke e çuar numrin e popullsisë, që jeton në qytetin e Pogradecit, për vitin 2004, në 38.000 banorë.

*Tabela 1 - Ndryshimi i numrit të popullsisë për periudhën 1997-2002*

| Viti | Të vendosur | | | Të shpërngulur | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Meshkuj | Femra | Meshk + femra | Meshkuj | Femra | Mesh. + Femr. |
| 1997 | 580 | 660 | 1240 | 82 | 165 | 247 |
| 1998 | 599 | 673 | 1272 | 95 | 141 | 236 |
| 1999 | 499 | 611 | 1110 | 106 | 171 | 277 |
| 2000 | 797 | 813 | 1610 | 133 | 204 | 337 |
| 2001 | 673 | 722 | 1395 | 169 | 286 | 455 |
| 2002 | 513 | 587 | 1100 | 222 | 330 | 552 |



# I. Vlerësim i situatës mjedisore në qytetin e Pogradecit

Qyteti i Pogradecit shtrihet në një territor prej rreth 233,4 ha, ndërkohë që kufiri i qytetit (vija e verdhë) përfshin një territor prej rreth 186,7 ha. Aktualisht, qyteti është shtrirë përtej vijës kufizuese të miratuar me rreth 47 ha, kryesisht në territoret e rrafshta në drejtimin lindor, në dy anët e rrugës së Tushemishtit dhe në drejtimin juglindor, në të dy anët e rrugës Pogradec-Korçë. Përgjithësisht, janë ndërtime pa leje në pronë private (të parregullta ).
Zona e banimit përfshin përqindjen më të lartë (85%) të sipërfaqes së përgjithshme të territoreve të qytetit. Shkalla ekzistuese e ndërtimit në qytet ka lartësi mesatare 2,7 kate. Ndërkohë që, numri më i madh (75%), për pasojë dhe sipërfaqja më e madhe e territorit të zonës së banimit, përbëhet nga ndërtesa të ulta 1-2 kate. Numri i ndërtesave 4 e më shumë katëshe, vendosur kryesisht në zonën e qendrës së qytetit, është i kufizuar (9%).

dëmtimin e shtresës së sipërme të asfaltit. Kjo është e dallueshme, veçanërisht në rrugët dytësore, pasi në rrugët kryesore, punimet e mirëmbajtjes përgjithësisht janë kryer.
Me ndërtimin e rrjeteve të reja të infrastrukturës (rrjetit telefonik ose rikonstruksione të ndryshme të rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit, etj) dhe për shkak të moszbatimit me cilësi të punimeve, në pjesën kaluese të rrugëve, vërehen ulje të shtratit të rrugës, prishje të asfaltit, gjë që ka sjellë ngushtimin artificial të pjesës kaluese të automjeteve.
Në qytet, ekzistojnë sheshe, kryesisht të përqendruara aty ku kanë fillimin e tyre disa rrugë. Funksionojnë dhe sheshe për lëvizjen e këmbësorëve, që janë kryesisht pranë zonës së qendrës, në territoret përreth Bashkisë dhe ish-shtëpisë së oficerave. Në përgjithësi, gjendja teknike e tyre është e mirë, por janë kryer pak punime mirëmbajtje për to.

*Tabela 2: Treguesit urbanistikë të qytetit të* Pogradecit

| Emërtimi i zonës | Sipërfaqja | | |
|---|---|---|---|
| | ha | Gjendja m2/ban | Norma m2/ban |
| Territor banimi | 165 | 45 | 30 |
| Territor i ob.shoqërore | 4,5 | 1.2 | 7 |
| Territor i gjelbërt | 10 | 2.7 | 7 |
| Territor sportiv | 4.6 | 1.3 | 2 |
| Territor rrugë + sheshe | 15.9 | 4.3 | 9 |

Ndërtesat me 3-4 kate ndodhen kryesisht në juglindje. Banesat e ulta e oborre qarkojnë zonat me ndërtime më të larta.
Zona e banimit rezulton me mangësi, përsa i përket elementëve përbërës të saj. Këtë fakt e shprehin treguesit urbanistikë, të renditur në tabelën e mëposhtme, krahasuar me treguesit normativë, të përcaktuar në Rregulloren e Urbanistikës.

## 1.1 Gjendja teknike e rrjetit rrugor, shesheve, trotuareve

Sipërfaqja e përgjithshme e rrugëve, shesheve dhe trotuarëve përfshin 8,38 % të sipërfaqes së qytetit brenda vijës së verdhë, ose 6,67 % të sipërfaqes së përgjithshme të tij. Rrjeti rrugor, në qytet, paraqitet përgjithësisht i dëmtuar. Vitet e fundit, shtimi i lëvizjes së automjeteve, moskryerja e punimeve të mirëmbajtjes dhe mosfunksionimi i kolektorëve të shkarkimit të ujrave të bardha, kanë sjellë si pasojë

Me trotuare janë të pajisura përgjithësisht rrugët kryesore të qytetit dhe janë në gjendje relativisht të mirë. Sipërfaqet e trotuareve janë të shtruara kryesisht me pllaka, aktualisht mjaft të amortizuara dhe të dëmtuara.

## 1.2 Rrjeti i kanalizimeve

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve të ujrave të zeza.
Uji i përrenjve, përgjatë bregut, afër Tushemishtit, pompohet në një rezervuar sipër qytetit të Pogradecit, me kapacitet minimal 200 l/sek. Si pasojë e kapacitetit të ulët të pompimit (120 l/sek) dhe e humbjeve në rrjet, rreth 30% e konsumatorëve ka ujë të rrjedhshëm vetëm 10 orë në ditë, ndërkohë që kërkesa për ujë është rreth 130 litra për person gjatë 10 orëve.
Sistemi i kanalizimeve të qytetit është i shtrirë (përgjatë bregut 30-40%) me drejtim nga perëndimi në lindje, paralel me vijën e bregut. Ujërat e zeza



të aksit kryesor pompohen nga 3 stacione pompimi në një kanal që vuan nga infiltrimet dhe punon në gjendje mbingarkese, sidomos gjatë periudhës së shirave. Kjo ka sjellë që ujrat e ndotura të rreth 38.000 banorëve të derdhen në liqen në mënyrë direkte. Në zonën që nuk është lidhur në sistemin e kanalizimeve, bëhet derdhja direkte e këtyre ujërave në përrenj.
Ujësjellës Kanalizime (UK) sh.a Pogradec, kryen aktivitetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujrave të zeza për bashkinë Pogradec. Në këtë zonë, numri i klientëve është rreth 26.000 konsumatorë familjarë, 400 subjekte private dhe 25 subjekte shtetërore.
Prodhimi realizohet nëpërmjet 2 stacioneve të pompimit të ujit të pijshëm në Tushemisht dhe Guras. Stacioni i Tushemishtit përballon furnizimin me ujë të pijshëm të bashkisë Pogradec (dhe të fshatrave Tushemisht, Vërdovë, Rëmenj). Në këtë stacion janë instaluar 5 elektropompa. Stacioni i Gurasit përballon furnizimin me ujë të pijshëm të fshatrave. Në këtë stacion janë instaluar 2 elektropompa me prodhim total 45 l/s.
UK sh.a. Pogradec, ka kryer studimet e nevojshme për ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme, duke realizuar një sërë përmirësimesh në sistem. Të gjitha këto ndihmuan në përmirësimin disi të situatës në furnizimin me ujë të konsumatorëve, pavarësisht nga rritja tepër e madhe e konsumatorëve në zonën e qytetit (bashkisë), ku numri i popullsisë në zonën e shërbimit të bashkisë është rritur nga 32.200, në vitin 1997, në 38.850 në vitin 2003.

## 1.3 Sistemi i shpërndarjes

Mirëmbajtja e rrjetit shpërndarës kryhet nga dega teknike e UK sh.a. Pogradec. Ky rrjet është tepër i amortizuar, për shkak të moshës së tij, dhe si i tillë kërkon shpenzime të mëdha për mirëmbajtjen e tij. Këto shpenzime, deri tani, janë përballuar nga shoqëria, për të minimizuar humbjet në rrjetin e brendshëm, shqetësimet në furnizimin me ujë të pijshëm tek qytetarët. Gjithashtu, janë eleminuar në kohë defektet e paraqitura, në mënyrë që të shmangeshin ndotjet në rrjet. Këtë e tregon edhe mospatja e problemeve të shëndetit të shkaktuara nga ndotjet në rrjet.

## 1.4 Largimi i ujrave të zeza dhe mirëmbajtja e qytetit

Gjendja e rrjeteve dhe stacioneve të pompimit të ujrave të zeza ka qenë tejet e rënduar, për shkak të shkallës së lartë të amortizimit të tyre, si dhe shërbimit të pamjaftueshëm, që është bërë në të kaluarën. UK sh.a. Pogradec ka bërë një sërë pastrimesh, në tubacionet kryesore dhe pusetat e kontrollit, me objektivin që, më pas, të funksiononte e gjithë skema, e cila kërkonte ndërhyrjen e plotë në stacionet e pompimit, por nuk u realizua për mungesë fondesh .
Për të mbrojtur cilësinë e ujit të Liqenit të Ohrit u vu në zbatim Projekti i Menaxhimit të Ujit, Kanalizimeve dhe Drenazhimit. Kështu, qeveria gjermane, nëpërmjet *Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW),* dhe qeveria zviceriane, nëpërmjet *Staatssekretariat fur Wirtschaft (SECO),* siguruan fondet e nevojshme për ngritjen e një infrastrukture të plotë pastrimi.

*Grafik.1 - Ndotja e ajrit nga djegia e lëndës drusore*
Në qytet konsumohet rreth 20 000 m 3
ose 10 ton lëndë drusore




## 1.5 Gjendja e ajrit, mjedisit, mbetjeve urbane

Qyteti i Pogradecit, në 10 vjeçarin e fundit, si rezultat i lëvizjeve demografike, ka patur një rritje të numrit të popullsisë, si rezultat, ka një rritje të aktivitetit njerëzor në të gjitha sferat. Kjo ka sjellë që edhe nivelet e ndikimit në mjedis të rriten.
Ndotja e ajrit mund të shkaktohet prej aktivitetit të njeriut, por edhe nga fenomenet natyrore, siç janë zjarret në pyje, etj. Shkaqet kryesore duhen kërkuar në zhvillimin industrial, ekonomik dhe në kushtet e jetesës. Mund të përmenden zmadhimin e qytetit, rritjen e trafikut, rritjen e konsumit të energjisë



si dhe zhvillimin e ekonomik, sidomos sektori i ndërtimit.
Në qytetin e Pogradecit, ajri ndotet, kryesisht, nga djegia (dru zjarri, kaldaja, furra buke me solar), nga automjetet e qytetit si dhe nga ato që kalojnë në rrugën kombëtare Tiranë-Korçë (rruga kalon përmes qytetit), veprimtari të tjera si: dyqane për saldime, zdrukthtari, punime metalesh, etj, pluhuri i rrugëve, pluhuri nga ndërtimet dhe prishjet. Një ndotës tjetër me rëndësi janë dhe sobat që përdoren nëpër shtëpi.
Faktorët meteorologjikë luajnë rol të madh në shpërndarjen e ajrit. Fenomene të tilla si erërat, temperatura, reshjet, mund të zvogëlojnë dhe ndihmojnë në hollimin dhe largimin e papastërtive, por, në raste të veçanta, mund të krijojnë komponentë të tjerë nën efektin e rrezatimit diellor.

## 1.6 Ndotja nga automjetet

Qyteti i Pogradecit, duke qenë i pozicionuar në nyje të rëndësishme rrugore të vendit, ka si rezultat dhe një trafik të konsiderueshëm rrugor, me të gjitha llojet e mjeteve, që nga mjetet me fuqi motorike të vogël, deri në ato me fuqi të madhe dhe me ndotje të lartë. Përveç automjeteve që zotërojnë banorët e qytetit, gjatë të gjithë vitit, qyteti duhet të përballojë dhe trafikun e madh që zhvillohet në rrugën kombëtare Tiranë – Korçë, e cila kalon mespërmes qytetit, duke e shtuar numrin e makinave që gjenden në një ditë të caktuar në qytet.

*Tabela 3 - Numri i mjeteve motorike sipas sektorëve*

| Lloji i automjeteve | Sektori privat | Sektori shtetëror | Totali |
|---|---|---|---|
| Autovetura | 1001 | 39 | 1040 |
| Autobusë mbi 32 vende | 28 | 3 | 31 |
| Mikrobusë nën 32 vende | 267 | 13 | 280 |
| Furgona deri në 3 ton | 222 | 2 | 224 |
| Kamionë mbi 3 ton | 168 | 11 | 179 |
| Traktorë rrugorë | 12 | 4 | 16 |
| Totali | 1698 | 72 | 1770 |

*Tabela 4 - Numri i mjeteve sipas llojit të karburantit*

| | |
|---|---|
| Nr totali i automjeteve që përdorin naftë | 1674 |
| Nr totali i automjeteve që përdorin benzinë | 96 |
| Përqindja e automjeteve që përdorin naftë | 94% |
| Përqindja e automjeteve që përdorin benzinë | 5% |
| Kilometrashi i regjistruar km/dit naftë | 100 |
| Kilometrashi i regjistruar km/dit naftë | 100 |
| Përqindja e squfurit (vlerë mesatare) naftë | 0,9% |
| Përqindja e squfurit (vlerë mesatare) benzinë | 1% |
| Gjatësia e rrjetit rrugor brenda qytetit (km) | 15 km |

*Tabela 5 - Vlerësimi i ndotjes totale*

| Ndotësit | Sasia e shkarkuar nga automjetet | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Benzinë (kg/dit) | Naftë (kg/dit) | Total (kg/dit) | Total ton/vit |
| $NO_x$ | 5 kg | 173,2 | 178,2 | 70,1 |
| $SO_2$ | 8,7 kg | 90,3 | 99 | 24,6 |
| CO | 67,4 kg | 2,5 | 62,9 | 22,6 |
| HC | 4,8 kg | 82,8 | 87,6 | 31,4 |
| Pluhura | 0,27 kg | 42,6 | 42,8 | 15,3 |



## 1.7 Mbetjet urbane

Grumbullimi i mbetjve urbane dhe transporti i tyre për në vendgrumbullimin afër minierës Alarup, 14,1km larg qytetit, bëhet nga kompania e pastrimit “REI” sh.p.k, e cila ka lidhur kontratë me Bashkinë e Pogradecit.

Grumbullimi i mbetjeve bashkiake bëhet nëpërmjet 120 kontenierëve, të shpërndarë në të gjithë qytetin. Sasia e mbetjeve, që grumbullohen dhe largohen mesatarisht, në ditë, është 36 ton.

Vendet e mbledhjes së mbetjeve dezinfektohen me pluhur gëlqere, me 5% përmbajtje klori, në periudhën prill-tetor. Në periudhën e sezonit veror, sasia e mbetjeve të grumbulluara arrin deri në 45 ton në ditë, si rezultat i mbipopullimit të qytetit. Nga mbingarkesa e mbeturinave, bëhet edhe zbrazja e kontenierëve, në rrugët kryesore, 2-3 herë në ditë. Transporti i mbetjeve për në vend depozitim bëhet me mjete teknologjike të përshtatshme, me kapacitet deri në 10 ton.

Një herë në muaj, në fushën e grumbullimit të mbetjeve bëhet shtyrja, sistemimi dhe mbulimi me dhe i mbeturinave (kavaletat). Pra, përdoret metoda e kompostimit. Fusha e grumbullimit të mbeturinave, në afërsi të minierës Alarup, ku grumbullohen dhe kompostohen mbetjet e qytetit të Pogradecit, është një fushë provizore pasi ka ndikime negative në mjedisin e zonës përreth Liqenit të Ohrit, zonë e cila ka statusin “zonë e mbrojtur”.

Hedhja e pakontrolluar, prej vitesh, e mbetjeve urbane, në zonën gëlqerore karstike të Zagorçanit, ka çuar më tej ndotjen e Lumit të Çërravës dhe ujrave të Liqenit të Ohrit, duke rrezikuar në të ardhmen edhe ndotjen e burimeve ujore të Tushemishtit e Zagorçanit, të shfrytëzuara për banorët e qytetit e zonës përreth.

Është hartuar një projekt, me ndihmën e bankës gjermane KFW dhe agjencisë suedeze SIDA, për ndërtimin dhe funksionimin e një fushe të re për grumbullimin e mbetjeve të qyteteve Korçë, Pogradec, Maliq, Bilisht e komunave përreth, në fshatin Maliq.

Problem tjetër, në zonën mbi fshatin Zagorçan, është edhe rehabilitimi i të gjitha fushave të grumbullimit të mbetjeve, duke bërë edhe sistemimin dhe mbulimet e mëdha dhe pastaj duke i pyllëzuar ato.

Në qytetin e Pogradecit, ka probleme me administrimin e mbetjeve të ngurta, të cilat krijohen nga biznesi i ndërtimit , biznesi prodhues (përpunim druri, prodhime metalike, mermeri e ushqimore), nga rikonstruksioni i ndërtesave apo hyrjeve të pallatit etj. Ndonëse ka rregulla e ligje që i detyrojnë prodhuesit e këtyre mbetjeve t’i çojnë ato me shpenzimet e veta për tek vendi i depozitimit të mbetjeve, kjo nuk ndodh, duke përfituar nga mungesa e kontrollit, pasi në shumicën e rasteve ato hidhen natën në vendet e hedhjes së mbetjeve bashkiake, pranë kontenierëve.

Për të minimizuar dhe eleminuar mbetjet e ngurta, që ndotin qytetin është punuar në dy drejtime kryesore nga pushteti vendor dhe në bashkëpunim me OJF-të mjedisore:

1. Së pari, ndërgjegjësimi i komunitetit, për mbajtjen pastër të qytetit, për të plotësuar kushtet e një qyteti turistik, nëpërmjet zhvillimit, më tej, të traditës qytetare pogradecare.
2. Së dyti, njohja sa më e plotë e të gjithë bazës ligjore në fushën e mjedisit si dhe të rregulloreve dhe urdhëresave të miratuara në Këshillin Bashkiak.
3. Së treti, rritja së forcës goditëse e parandaluese nga Policia Bashkiake e Inspektoriati i Mjedisit Urban, nëpërmjet zbatimit të ligjeve dhe Urdhëresesë së Këshillit Bashkiak në zbatim të parimit “kush ndot paguan”, duke gjobitur çdo rast të kundraligjshëm që vihet re.

Për të patur gjendjen nën kontroll, nga ana e pushtetit vendor në Pogradec, është parashikuar caktimi i disa pikave në qytet ku do të vendosen konteinerë 5 $m^3$ për grumbullimin e mbetjeve të ngurta në sasi më të vogla se 1/10 $m^3$ , mbetje të cilat dalin nga riparime të ndryshme që kryejnë qytetarët në mjediset e banimit. Ndërsa sasitë e mbetjeve, që janë më të mëdha se 1/10 $m^3$, janë detyrim i qytetarëve apo i objekteve ndërtuese e prodhuese për t’i larguar ato.

Nga ana e Bashkisë, po studiohet dhe planifikohet një fushë tjetër më e përshtatshme dhe më afër qytetit, duke eleminuar hedhjen e pakontrolluar të mbetjeve të ngurta në gropat e rërës në fushën e Starovës, në anën e rrugës Zagorçan –Qafa e Kukës, në anë të lumit mbi fshatin Vërdovë, në anën e majtë të rrugës Pogradec- Guri i Kuq dhe në anë të lumit të Tërhamit.

Marrja e masave të menjëhershme për të ndaluar hedhjen e pakontrolluar të mbetjeve të ngurta është domosdoshmëri për mbrojtjen e mjedisit të pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit. Prandaj duhet të bëhet ndërprerja urgjente e hedhjes së mbetjeve urbane brenda pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit dhe gjetja e një sheshi provizor jashtë këtij pellgu nga ana e pushtetit vendor, deri sa të filloje funksionimi i fushës së mbetjeve në fshatin Maliq të rrethit të Korçës.

Gjithashtu, në zonën mbi fshatin Zagorçan, duhet të merren masa urgjente për rehabilitimin e plotë të disa fushave të mbyllura të grumbullimit të mbetjeve.



Duhet të bëhet në mënyrë të plotë mbulimi me dhe, sistemimi dhe pyllëzimi i tyre, duke eleminuar të gjitha ndikimet negative që kanë në mjedisin e kësaj zone.

Në fushën ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve, bëhet ndarja dhe riciklimi i hekurishteve të ndryshme, të kanoçeve etj., në mënyrë spontane, nga komuniteti rom. Në të ardhmen, janë planifikuar të zbatohen projekte të ndryshme për të bërë ndarjen e mbetjeve të qelqit, të letrës, hekurishteve, plastikave, që në burimin e krijimit të tyre. Kjo, fillimisht, mendohet të bëhet në shkolla e kopshte, në bar-restorante dhe në një lagje pilot në qytet.

Në drejtim të grumbullimit dhe asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, ku hyjnë ato spitalore, bateri makinash, kuti boje e fuçi llaku e dylieni, duhet të merren masa më të plota e të mos trajtohen njëlloj si mbeturinat bashkiake në fushën e grumbullimit të tyre.

Gjysma e mbetjeve krijohen nga veprimtaria ndërtimore, prandaj del e domosdoshme ndërtimi i një impianti për të bërë të mundur riciklimin e materialeve të ndërtimit.

Mbetjet e ish fabrikës së pasurimit të hekur-nikelit në Gur të Kuq, ato të ish stacionit të mallrave Mëmëlisht, së bashku me stoqet minerale të hekur-nikelit dhe qymyrit të zonës industriale (fare pranë bregut të liqenit), të grumbulluar në sasi disa mijëra




*Graf.2*
*Përbërja e mbetjeve të qytetit të Pogradecit (2004)*

ton, prej vitesh, janë bërë burim ndotje i kësaj pjese të liqenit. Evadimi i dy stoqeve minerale jashtë pellgut ujëmbledhës të liqenit dhe hartimi i një plani rregullues për zonën e mësipërme, me potencial real turistik mbetet detyrë urgjente për mjedisin e kësaj zone.

Problematike në ndotjen e liqenit janë edhe prurjet e ngurta që sjellin Lumi i Qytetit dhe ai i Vërdovës. Megjithëse, herë pas here, janë bërë pastrime të prurjeve të ngurta të lumenjve me fondet e Bashkisë, për një zgjidhje më të plotë të këtij problemi duhen bërë sistemimi i tyre (veshja me beton e anëve dhe shtratit të tyre), si dhe ngritja e pritave për të parandaluar përmbytjet e qytetit në rastet e reshjeve të shumta.

## 1.8 Gjendja e lumenjve të qytetit

Qyteti i Pogradecit ka dy lumenj: Lumi i Qytetit, që ka derdhjen tek "Oktapodi" dhe Lumi i Vërdovës me derdhje tek "Bar 1 Maji". Herë pas here, janë dhënë fonde nga bashkia e qytetit për t'u bërë pastrimi i shtratit të lumenjve nga mbetjet e ngurta. Kështu, firma "Rei" dhe KREK", gjatë vitit 2002-2003, ka larguar rreth 10.000 ton mbetje të ngurta nga shtretërit e të dy lumenjve. Ky pastrim ishte emergjent, pasi u bë parandalimi i përmbytjes së qytetit (në periudhën e reshjeve të vjeshtës). Përgjatë shtratit të lumenjve janë ndërtuar mjaft banesa private, të cilat, shpesherë, bëjnë hedhjen e mbetjeve familjare në lumenj. Për të shmangur këtë fenomen, janë vendosur konteinerë mbeturinash në të dy anët e lumenjve dhe bëhet pastrimi i përditshëm i tyre.

Në një pikë kritike paraqitet cilësia e ujit të lumenjve, pasi atje bëhet përzierja e ujit të rrjedhës së lumenjve me ujrat e zeza, që derdhen në lumenj si pasojë e ndërhyrjeve pa leje.

Kjo gjendje kritike ka bërë që, për vitin 2004, këshilli bashkiak të marrë një sërë masash për sistemimin e shtratit të lumenjve, prishjen e ndërtimeve pranë shtratit të lumenjve, ngritjen e hapësirave publike në të dy anët e lumenjve, sistemimin e tyre me rrugë, trotuare, ndriçim dhe gjelbërim.

## 1.9 Gjelbërimi

Toka, në qytetin e Pogradecit, në bazë të analizave gjeologjike, përbëhet, kryesisht, nga toka ranore – argjilore.

Qyteti i Pogradecit është njohur si qytetit i luleve dhe zhvillimi i kësaj tradite ka qenë përparësi e politikave bashkiake. Kështu, gjatë viteve 2002-2003, janë kryer një sërë investimesh si: i) rikonstruksioni i shëtitores buzë Liqenit të Ohrit; ii) vendosja e një



sistemi ujitje në parkun buzë liqenit; iii) nivelimi i sipërfaqes së gjelbër dhe përmirësimi i cilësisë së barit; iv) rehabilitimi i pjesëve të parkut prej nga u hoqën kioskat, lokalet, ndërtimet me leje provizore (të përkohëshme, sezonale); v) rehabilitimi i rrugicave brenda parkut; vi) vendosja e sistemit të ndriçimit në park; vii) vendosja e stolave në park, sheshet para pallateve; viii) vendosja e koshave ditorë dhe konteinerëve në parkun buzë liqenit (zëvendësimi i përvitshëm i tyre); ix) mirëmbajtja e sipërfaqes së gjelbëruar.

## 1.10 Gjendja e lulishteve në qytet

Ndërmarrja e gjelbërimit, me vendim të Këshillit Bashkiak, bëri kalimin nga sipërmarrje private në ndërmarrje shtetërore, ku objekti i punës është mirëmbajtja dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara. Këto sipërfaqe shtrihen në zonën e bregut të liqenit dhe në pjesën e qendrës së qytetit.
Sipërfaqja e gjelbëruar është 5.5 $m^2$/banor, ku nuk është përfshirë gjelbërimi në kurorën e qytetit. Kjo sipëfaqe u shërben 38.000 banorëve vendas, si dhe rreth 20.000 turistëve në periudha të caktuara të vitit. Lulishtja, tek shëtitorja "Fan Noli" u rehabilitua komplet duke mbjellë dru dekorativ në të dy anët e shëtitores, me gjerësi 5 m, gjithashtu dhe me 2 breza anësorë me lule, si manushaqe, lule zjarri, lule syze, karafila e trëndafila. Vlen të përmendet këtu edhe disiplinimi i lëvizjes së automjeteve në shëtitoren "Fan Noli".

## 1.11 Gjendja e gjelbërimit të blloqeve të qytetit

Një nga politikat e bashkisë është rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe sipërfaqeve me lule në brendësi të qytetit, midis blloqeve të pallateve, duke mbjellë drurë dekorativë si gështenjë e egër, unapi, plepi, tija, bredh, pishë, lis etj.
Një vëmendje e veçantë u është kushtuar mjediseve publike shtetërore si shkolla, kopshte, çerdhe, institucione dhe ndërmarrje shtetërore, të cilat i mirëmbajnë këto mjedise me kapacitetin e tyre, duke vendosur kopshtarë, që kujdesen për sipërfaqet e gjelbra brenda territorit të tyre.
Kështu, çdo vit, mbillen rreth 100 rrënjë fidanë të rinj, duke bërë ripërtëritjen e drurëve të dëmtuar dhe shtimin e numri të pemëve të mbjella. Gjithashtu, po punohet për rehabilitimin e ligustrave duke i krasitur dhe duke i dhënë forma mjaft të këndshme lulishteve (ligustrave).

Vlen të përmendet puna dhe kontributi që po japin pronarët e lokaleve, hoteleve, firmave të ndryshme të prodhimit, nëpërmjet rregullimit të mjediseve pranë biznesit të tyre, që, tashmë, është bërë një nga punët rutinë të tyre. Shembuj mjaft të mirë janë Hotel Turizmi, "EuroKorça", Pastiçeri "Tushi", Bar "1 Maji", Birra "Pirro", Firma "Fani" etj.
Bashkia e qytetit dhe këshilli bashkiak u kanë dhënë rëndësi të veçantë dhënies së lejeve të ndërtimit, duke bërë edhe miratimin e mjediseve çlodhëse përreth banesave që do të ndërtohen.

Fama e Pogradecit si qyteti i luleve, ka ardhur si rezultat i punës të çdo banori që e do qyetetin e tij.. Një nga traditat e qytetit është kultivimi i pjergullave dhe drurëve frutorë e dekorativë në banesat private si dhe kultivimi i saksive të ndryshme nëpër ballkone dhe mjediset e shtëpive në banesat publike.
Për të ndikuar në ndërgjegjësimin dhe në rritjen e interesit të qytetarëve ndaj kultivimit të luleve në mjeediset e shtëpive, bashkia e Pogradecit organizon, në muajt gusht-shtator, konkursin për lulet më të bukura, të rritura në mjediset e shtëpisë. Qytetarët pogradecarë, me anë të këtij konkursi, përpiqen të çojnë më tej traditën e hershme të qytetarisë pogradecare.

*Tabela 6 - Situata e sipërfaqeve të gjelbra*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja e gjelbëruar e qytetit është | 208.000 $m^2$ |
| Sipërfaqe me lule | 6.950 $m^2$ |
| Sipërfaqe me bar | 156.050 $m^2$ |
| Sipërfaqe inerte | 22.050 $m^2$ |
| Sipërfaqe ujore | 23.000 $m^2$ |
| Sipërfaqe me drurë dekorativë | 4.500 copë |
| Sipërfaqe me shkurre dekorative | 1.250 copë |
| Bordurë e gjelbër | 1.800 metër linear |

## 1.12 Energjia

Përdorimi i energjisë, plotësimi i nevojave.
Deri tani, pjesa më e madhe e kërkesës për energji për ngrohje është plotësuar nga drutë e zjarrit, shumë



pak me gaz dhe pjesa tjetër me energji elektrike. Po kështu, në disfavor është edhe konsumi për gatim.
Konsumi mesatar për familje, nga viti në vit, ka një rritje të lartë dhe, sot, ai është në nivelin 250 kWh në muaj për familje. Fuqia e burimeve të energjisë elektrike, si kapaciteti i nënstacioneve, fuqia e kabinave të instaluara në qytet, si dhe rrjeti shpërndarës i T.M dhe T.U është i tillë që përballon nevojat e konsumatoreve në qytet.
Por problemet qëndrojnë në pamundësinë e K.E.SH për furnizim 24 orësh. Në këto kushte nevojat plotësohen në masën 90%.
Meqenëse politika e K.E.Sh-it është e tillë që, brenda vitit 2007, do të merren masat për plotësimin e nevojave kombëtare, ky problem quhet i zgjidhur.
Çka theksuam më lart është e besueshme edhe për faktin tjetër se pagesa e faturës nga ana e qytetarëve pogradecarë është në nivelin mbi 95%.
Raporti i përdorimit të energjisë familjare dhe jofamiljare aktualisht është 2 me 1 në favor të të parëve.

## 1.13 Ndriçimi publik në qytet

Rrjeti i ndriçimit publik ekzistues shtrihet në një gjatësi prej afërsisht 23 km dhe mbulon rreth 75% të nevojave për ndriçim dhe u shërben rreth 80% të banorëve të qytetit, bizneseve, institucioneve etj.
Ndriçimi publik përfshin rrjetin e ndriçimit të shpërndarë si: ndriçimi i rrugëve kryesore, ndriçimi i rrugëve të brendshme, ndriçimi i shesheve, parqeve, lulishteve dhe ndriçimi i institucioneve.
Zonat problematike me mungesë shërbimi ose me shërbim në gjendje të keqe për ndriçimin publik janë blloqet e banimit si blloku i ish fermës, blloku i trekëndëshit, hyrja nga Korça, lagjja Përroi i Çaprazit, pjesa e sipërme, blloku tek ish kampi i pionerëve, blloku tek lagjia nr. 5, blloku tek lagjia nr. 2 etj

## 1.14 Mundësitë për futjen e burimeve të reja të energjisë

Përdorimi i alternativave të tjera për sigurimin e energjisë është më shumë një tendencë kombëtare sesa lokale.
Eshtë politika energjitike kombëtare ajo që do të bëjë të mundur futjen apo përdorimin e burimeve të tjera të energjisë. Megjithëse nuk disponohen të dhëna të sakta, ka një rritje të konsumit të gazit të lëngshëm për gatim. (pjesë e konsumit për ngrohje është ajo pjesë që zëvendëson mospërdorimin e druve të zjarrit).
Përdorimi i energjisë diellore është thuajse i papërfillshëm.
Kushtëzimi i ngrohjes kolektive në pallatet e reja, me burim energjie naftën apo gazin e lëngshëm, do të ishte një mundësi.

## 1.15 Vlerësimi i dëmtimeve në sistemin elektrik – efiçenca e energjisë

Dëmtimet në rrjet kanë çuar në humbje të mëdha të energjisë, të cilat llogariten në nivelet 30-35% të energjisë të blerë nga nënstacioni, që do të thotë se humbjet joteknike (abuzimi) janë në masën 10-15%. Ky nivel abuzimi, krahasuar me atë në shkallë vendi është mjaft i ulët, por sidoqoftë i papranueshëm.
Momentalisht (2004), në Pogradec, zhvillohet një turizëm intensiv gjatë dy muajve të verës (korrik, gusht). Ky turizëm konsiston në turizmin familjar, në hotelet e motelet ekzistuese. Tendenca kryesore, në bazë të Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri, deri në vitin 2012, është kthimi i gjithë qytetit dhe bregut liqenor Pogradec - Lin dhe Pogradec - Tushemisht në një mjedis turistik me gjithë infrastrukturën e nevojshme turistike.
Një tendencë e rëndësishme e zhvillimit të turizmit në Pogradec, sot dhe në të ardhmen e afërt, është turizmi familjar. Tradicionalisht, familjet e qytetit të Pogradecit, si dhe fshatrave Tushemisht dhe më pak Starovë e kanë zhvilluar edhe në të kaluarën. Pushues nga Tirana, Elbasani, Korça, Shkodra etj., gjatë muajve të verës kalonin pushimet në Pogradec, në një mjedis mjaft mikpritës dhe të kulturuar.
Familjet, që presin turistë sot, kanë bërë investime për t'i sjellë mjediset e tyre në nivelin e kërkesave që shtron koha.
Për të zhvilluar me efikasitet këtë degë të rëndësishme të turizmit në Pogradec, duhet që shteti (Bashkia), bankat dhe OJF-të të punojnë më mirë për të influencuar në financimin (me kredi) familjet e qytetit dhe ato të fshatrave për të realizuar nevojat për një turizëm të qëndrueshëm dhe mundësisht gjithëstinor.
Tendenca tjetër e zhvillimit të turizmit në Pogradec, janë investimet e rëndësishme që janë kryer në Pojskë (kompleksi "Lyhnidas"; apo në fshatin Tushemisht "Milenium" "Sirena" "Shën Marena" në Drilon "Vila Art", "Këmilli" etj) pa përmendur këtu "Enkelana", "Tea", "Borana", "Desaret", "Eurokorça" etj. Pra tendenca e biznesit në këtë drejtim është e prekshme, por ajo duhet të numërojë më shumë investitorë.
Numri i turistëve, që vizitojnë Pogradecin në një vit, është ndërmjet 25.000 – 30.000 persona, nga të cilët 500 janë të huaj, me një tendencë në rritje.
Pogradeci ka 300 ditë në vit me diell. Në periudhën e dimrit, përgjithësisht ka dëborë në malet përreth, që shoqëron kaltërsine e liqenit.
Ky pejsazh, që shpaloset në lartësinë 700 metra mbi nivelin e detit, shpalos vlera të tjera të pazbuluara kur fillon të ngjitesh maleve.



# II. Burimet natyrore dhe zhvillimi i turizmit

## 2.1 Gjendja

Momentalisht në Pogradec zhvillohet një turizëm me intensitet gjatë dy muajve të verës (korrik, gusht). Ky turizëm konsiston në turizmin familjar, në hotelet e motelet ekzistuese. Tendenca kryesore në bazë të Strategjisë së Zhvillimit të turizmit në Shqipëri deri në vitin 2012 është kthimi i gjithë qytetit dhe bregut liqenor Pogradec - Lin dhe Pogradec - Tushemisht në një mjedis turistik me gjithë infrastrukturën e nevojshme turistike.

Një tendencë e rëndësishme e zhvillimit të turizmit në Pogradec, sot dhe në të ardhmen e afërt është turizmi familjar. Tradicionalisht familjet e qytetit të Pogradecit, si dhe fshatrat Tushemisht dhe më pak Starovë e kanë zhvilluar edhe në të kaluarën. Pushues nga Tirana, Elbasani, Korca, Shkodra e të tjerë gjatë muajve të verës kalonin pushimet në Pogradec në një mjedis mjaft mikpritës dhe të kulturuar. Familjet që presin turistë sot kanë bërë investime për t'i sjellë mjediset e tyre në nivelin e kërkesave që shtron koha.

Për të zhvilluar me efikasitet këtë degë të rëndësishme të turizmit në Pogradec duhet që shteti (Bashkia), bankat dhe OJF-të të punojnë më mirë për të influencuar në financimin (kredi) për të realizuar familjet e qytetit dhe ato të fshatrave nevojat për një turizëm të qëndrueshëm dhe mundësisht gjithë stinor.

Tendenca tjetër e zhvillimit të turizmit në Pogradec janë investimet e rëndësishme sic janë kryer në Pojskë (Kompleksi "Lyhnidas"; apo në fshatin Tushemisht "Milenium" "Sirena" "Shën Marena" në Orilon "Vila Art", "Kërmilli" etj) pa përmendur këtu "Enkelana", "Tea", "Borana", "Oesaret", "Eurokorga" etj. Pra tendenca e biznesit në këtë drejtim është e prekshme, por ajo duhet të numërojë më shume investitorë.

Nr. i turistëve që vizitojnë Pogradecin në një vit është ndërmjet 25 000 – 30 000 persona, nga të cilët 500 janë të huaj, me një tendencë në rritje.

Pogradeci ka 300 ditë në vit me diell. Në periudhën e dimrit në cdo kohë ke dëborën e maleve perreth, gjelbërimin e drurëve dhe fushave, ke kaltërsine e liqenit.

Ky pejzazh që shpaloset në lartësinë 700 metra mbi nivelin e detit shpalos vlera të tjera të pazbuluara kur fillon ngjitesh maleve.

## 2.2 Politika e zhvillimit të turizmit

Thelbi i politikave të qeverisjes vendore, në drejtim të turizmit, qëndron që këtë qytet turistik ta bëjë sa më të vizitueshëm nga turistët vendas dhe të huaj, për të arritur që, në Pogradec, të ketë një fluks sa më të madh turistësh gjatë verës dhe gjithashtu të ketë gjatë vitit një konstante të qëndrueshme. Në këtë drejtim, qeverisja vendore po punon për promovimin sa më mirë të turizmit, nëpërmjet reklamave, guidave, kartolinave, hartave dhe posterave me karakter turistik.

Është arritur ndriçimi i qytetit. Bregu i liqenit është pastruar nga kioskat, duke rritur ndjeshëm sipërfaqet e gjelbëruara buzë liqenit. Është në proces zgjidhjeje sistemimi i ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza, krijimi i mjediseve të kulturuara, disiplinimi i qarkullimit, rritja sipërfaqeve të gjelbëruara etj.

## 2.3 Liqeni i Ohrit

### 2.3.1 Gjeografia

Liqeni i Ohrit e ka origjinën 3 milion vjet më parë, nga depresioni gjeotektonik i Dinarideve Perëndimore. Lartësia mbi nivelin e detit është 695 m. Kufizohet nga masivi i Mokrës (1.589 m) dhe Jabllanica (1.945 m) nga ana e Shqipërisë, dhe brezi gëlqeror i Galicicës (2.255 m) në anën lindore. Malet përreth janë shumë të karstifikuara. Liqeni i Ohrit zë një sipërfaqe prej 358,2 $km^2$, prej të cilave 2/3 i takojnë Maqedonisë dhe 1/3 Shqipërisë. Liqeni ka një gjatësi bregu prej 87,5 km, një gjatësi maksimale 30.8 km, gjerësi maksimale 14.8 km, dhe thellësi maksimale 289 m (mesatarja 164 m).

### 2.3.2 Hidrologjia

Pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Ohrit përmbledh rreth 40 lumenj e përrenj, ku 23 janë në territorin e Shqipërisë dhe 17 në atë të Maqedonisë, por pjesa më e madhe e tyre thahen gjatë verës dhe janë të papërfillshëm përsa i takon prurjes së tyre në liqen. Avullimi vjetor përreth liqenit është vlerësuar në rreth 468 mm. Duke marrë në konsideratë rreshjet vjetore, prej 759 mm, del se prurjet përreth liqenit janë të barabarta me 2.81 l/sek. Uji qëndron për një kohë mesatare prej 60 vjetësh.

Korentet ujore në liqen kontrollojnë shpërndarjen e



ndotësve dhe shkallën e ndikimit të tyre në florën dhe faunën e liqenit. Lëvizja mbizotëruese horizontale e ujrave është ciklonike dhe në kahun e kundërt orar. Shpejtësia e korenteve ciklonike zvogëlohet në mënyrë progresive me rritjen e thellësisë dhe pëson një rënie nga më tepër se 0.1 m/sek në sipërfaqe, në vlerën 0 në thellësinë rreth 50 m.

### 2.3.3 Biodiversiteti dhe burimet natyrore

Liqeni i Ohrit përfaqëson një vend mbrojtës për një numër të madh organizmash të ujërave të freskëta të formave endemike dhe relike, të datuara në periudhën e Terciarit. Kushërinjtë e tyre të afërt mund të gjenden vetëm në mbeturinat e fosilizuara. Për shkak të moshës së madhe të liqenit dhe ekzistencës së tij të gjatë, të karakterizuar nga izolimi gjeografik dhe stabiliteti i kushteve të jetesës, procesi i diversifikimit në lloje vazhdon ende.

### 2.3.4 Fauna dhe flora e liqenit

Sipas autorëve të ndryshëm, bota e gjallë e Liqenit të Ohrit karakterizohet nga endemizmi, për shembull, për Infusoret: 88% e të gjitha llojeve janë endemike, *Rhabdacolea* dhe *Tricladida* (krimba të sheshtë turbelarianë): 44% dhe 71 % janë endemikë; *Gastropoda* (molusk): 90% endemik; *Ostracoda* (*crustacean*): 66% endemik; dhe peshku: 60% endemik.

Fauna e peshkut përfaqësohet nga 17 lloje autoktone në katër familje: *Salmonidae* (2 lloje), *Cyprinidae* (12 lloje), *Cobitidae* (2 lloje) dhe *Anguilidae* (1 lloj). Përsa i takon peshkimit, 10 lloje kanë vlera tregëtare.

Për arsye të larmisë së madhe të kushteve të jetesës, zona shkëmbore e liqenit karakterizohet nga një komunitet i pasur llojesh bimore e shtazore. Vegjetacioni makrofitik, si për shembull kallamishtet (*Phragmites communis*) janë të shpërndara kryesisht përgjatë brigjeve, që janë pak të ekspozuara ndaj erës dhe lëvizjes së valëve.

Dukepatur parasysh këto vlera natyrore të këtij rajoni, me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 80, datë 18.2.1999, është shpallur zona e Prespës "Park Kombëtar" dhe zona e Liqenit të Pogradecit "Peisazh i mbrojtur tokësor/ujor".

### 2.3.5 Mjedisi fiziko-kimik dhe cilësia e ujit të Liqenit të Ohrit

Në kuadër të këtij plani, po ndalemi në përqendrimin e fosforit dhe azotit në ujrat e liqenit.

Liqeni i Ohrit konsiderohet si një liqen oligotrofik. Përqëndrimi mesatare, në gjithë shtyllën e ujit, në pjesën qendrore të liqenit, luhaten ndërmjet vlerave 4,65-6.8 mg/l, për fosforin dhe 171-512 mg/l për azotin. Mesatarja e përqendrimit të përgjithshëm





të fosforit, në afërsi të qytetit të Pogradecit, luhatet ndërmjet 3-10 μg/l.

### 2.3.6 Cilësia e ujit në tributarët e Liqenit të Ohrit

Vlerësimi i ngarkesës me fosfor dhe me substanca të tjera, që hyjnë në Liqenin e Ohrit, është me rëndësi për të parashikuar të ardhmen e tij.
Përqendrimi i fosforit të përgjithshëm (μg/l), në tributarët e Liqenit të Ohrit, në pjesën shqiptare të tij është si më poshtë:

Vlerat mujore maksimale.

| | |
|---|---|
| Lumi i Pogradecit | 360 mg/L |
| Lin | 44 mg/L |
| Drilon | 110 mg/L |
| Çërravë | 76 mg/L |

Vlerat vjetore.

| | |
|---|---|
| Lumi i Pogradecit | 0,7 ton |
| Lin | 0,032 ton |
| Drilon | 2 ton |
| Çërravë | 1,27ton |
| | Σ= 3,5 ton/vit |

Në këtë vlerësim nuk janë përfshirë rreshjet e shirave.
(mg-miligramë, L-në dy largësi nga bregu)

### 2.3.7 Ndikimi njerëzor

Një nga rreziqet potenciale më të mëdha, për shëndetin e njerëzve që banojnë përgjatë Liqenit të Ohrit, është kontaminimi bakterial dhe me patogjenë të tjerë, që futen në liqen me ujërat e zeza të kanaleve. Prania e *Escherichia coli* në ekosistemin ujor tregon se ekziston një rrezik i madh për infektim, kurse në raste përqendrimesh shumë të larta edhe rreziku i përhapjes së epidemive. Përqendrime më të larta E. coli ka patur zakonisht në muajt e verës (sezoni turistik) ose në sezone të tjera pas shirave të rrëmbyer. Kur bien shirat tepër të rrëmbyer, kapaciteti i sistemit të kanalizimeve mund të tejkalohet dhe në liqen shkarkohen mbeturina të patrajtuara. Edhe ujrat nga shpëlarja e territoreve urbane sjellin baktere në liqen.
Ndotja bakteriale e ujit të zonës së bregut përfshin një numër të paidentifikuar burimesh të ndotjes nga mbetjet humane të papërpunuara. Gjatë verës, u morën mostra në tetë stacione pranë zonave më të mëdha urbane dhe rurale.

Në zonën e qytetit të Pogradecit, është vënë re nivel i lartë i ndotjes bakteriale. Numri i E.coli, në mostrat e ujit të marra në largësi 5 m nga bregu i kësaj zone, luhatet 240.000-1.100.000 për 100 ml ujë. Ndotja bie me rritjen e largësisë nga bregu, por natyrisht ajo është e lartë edhe në largësinë 50 m nga bregu dhe luhatet nga 24.000-460.000 E.coli për 100 ml





ujë. Këto nivele shumë të larta të ndotjes bakteriale të ujrave të bregut të kësaj zone shpjegohen me faktin se zona gjendet pranë burimeve të ndotjes, që është shkarkimi i mbetjeve urbane të lëngëta të patrajtuara. Natyrisht, ndotja bakteriale ulet me rritjen e largësisë nga bregu dhe në largësinë 200 m ujërat e liqenit, në zona të tjera të shqyrtuara, janë pa ndotje koliforme.

Llojet e peshqve me rëndësi tregtare në Liqenin e Ohrit, sidomos korani i famshëm, janë gjuajtur në nivele të paqëndrueshme gjatë viteve të fundit. Për pasojë, popullatat e koranit jane në rrezik për t'u zhdukur. Veprimtaritë njerëzore gjatë bregut janë kërcënim edhe për terrenet e lëshimit të vezëve të dimërimit, si për koranin ashtu dhe për peshqit e tjerë, duke përfshirë gjuhcën dhe krapin. Ndonjëri nga llojet e peshqve eshte një popullatë e vetme, për gjithë liqenin, ndaj ajo duhet administruar në mënyre të përbashkët, sipas të njëjtave rregulla në Shqipëri dhe Maqedoni.

Janë të nevojshme monitorime të tjera, të pavarura, për popullatat e peshqve, për të vlerësuar nivelin e qëndrueshëm të peshkimit të çdo lloji të tregtueshëm, nivel që merr parasysh potencialin natyror të riprodhimit të popullatave. Kur të jenë përcaktuar këto nivele, atëherë duhen harmonizuar rregullat e peshkimit në të dyja vendet, për të vendosur kufijtë e peshkimit, duke vendosur edhe detyrimin e zbatimit të rreptë të rregullave. Duhen mbrojtur me rregullore të rrepta edhe habitatet ujore të rrezikuara, duke përfshirë habitatet e lëshimit të vezëve gjatë bregut.

Projekti per Ruajtjen e Liqenit të Ohrit ka vendosur baza të mira për bashkëpunimin e autoriteteve vendore të të dyja vendeve, si dhe të individëve e grupeve nga të dyja anët e liqenit, të cilët po ndërgjegjësohen, gjithnjë e më shumë, për rolin e tyre në ekosistem.



# III. Trashëgimia kulturore

Qyteti si një artefakt kulturor

Qyteti është vepra kulturore më komplekse e dizenjuar dhe kryer nga dora e njeriut. Mënyra si është dizenjuar qyteti, çfarë reflekton ai, bazohet në kulturën lokale, kombinimin e vlerave të përbashkëta për të menduar. Çdo qytet ka një kulturë që i korrespondon kushteve të tij vendore dhe mjedisit të tij të jashtëm. Kjo kulturë pasqyrohet në panoramën urbane, ndërtesat e vjetra dhe të reja, mënyrën se si është ndërtuar qyteti, qëndrimin e tij ndaj hapësirës publike, jetën e tij sociale, ushqimet, produktet që lidhen me të, simbolet dhe ritualet e rëndësishme, këngët, kërcimet, mënyrën se si është organizuar qyteti dhe si menaxhohet.

Nëse flasim për gjendjen aktuale të kulturës të qytetit të Pogradecit, ajo karakterizohet nga një sërë problemesh dhe vështirësish. Duke marrë për bazë atë që natyrshëm trashëgojmë nga e kaluara, Pogradeci ka një trashëgimi të copëtuar dhe të paorganizuar. Rreth viteve '20 është formuluar koncepti urbanistik i qytetit, i cili ende nuk njihet. Urbanizimi i qytetit është spontan dhe i pamenaxhuar. Kështu, egërsia dhe spontaneiteti kanë dominuar hera herës cilësitë kulturore. Nuk është marrë në konsideratë dhe nuk kuptohet roli që duhet të ketë ruajtja e pejsazhit urban, në harmoni me atë natyror. Qyteti nuk funksionon harmonishëm dhe nuk ka kufij ndarës.

Rrugicat dhe banesat me vlera historike, arkitekturore dhe kulturore të qytetit janë në mëshirë të fatit, nuk ka asnjë ndërhyrje konkrete. Nyjet, sheshet dhe hyrjet në qytet janë tërësisht të neglizhuara dhe nuk përbëjnë arsye për kulturë.
Nga ana tjetër, qyteti ka një rrjet modest, por të vlefshëm, nëse do të funksiononin si duhet, të insitucioneve kulturore.

Institucionet kryesore kulturore të qytetit:
Biblioteka – ky institucion funksionon normalisht
Muzeu Historik - ka pësuar një degradim në funksionet dhe përmbajtjen e tij
Galeria e Artit - nuk funksionon në mënyrë profesionale.
Teatri i kukullave - luan një rol të mirë në aktivitetet e tij, duke arritur në realizimin edhe të një festivali mbarëkombëtar në këtë fushë, duke i dhënë qytetit një vlerë të veçantë.
Aktualisht, aktivitetet e tjera e zhvilluara nga Shtëpia e Pionierit dhe shkollat e qytetit janë më shumë spontane dhe nuk ka një përfshirje të tyre në një plan të përcaktuar kulturor.
Në fushën e trashëgimisë kulturore, ekzistojnë disa botime dhe memorie të shkruara apo të regjistruara, të cilat inkurajojnë zhvillimin e fushave të tilla të kulturës popullore si kënga qytetare, vallet tradicionale dhe ritualet, të cilat shfaqin ato burime të krijuara natyrshëm nga profesionistë apo amatorë. Gjithashtu, dhënia e titullit "Qytetar Nderi" nga Bashkia është një praktikë e vlerësuar kulturore.

Qyteti ka disa aktivitete kulturore të përvitshme si:
- Sofra poetike me pjesëmarrje ballkanike;
- Ditën e Liqenit (21 Qershor);
- Në ritualet e qytetit vlen të përmendim dhe ditën e "Ujit të bekuar".

Qyteti i Pogradecit ka nxjerrë dy poetë të mëdhenj Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli, të cilët janë poetë me vlera të mëdha kombëtare. Gjithashtu, qyteti mbart vlera të veçanta, si qyteti që ka pasur shkollën e dytë shqipe në vend. Shtëpitë e këtyre poetëve duhet patjetër të shapllen si muze, për shkak të vlera të mëdha që bartin.

Dy vende publike të rëndësishme për kulturën qytetare janë dhe Odeoni para Bashkisë dhe rruga turistike e munguar deri më tash, rreth të cilës të tregëtohen dhe promovohen burimet turistike dhe kulturore.
Odeoni duhet të rikonceptohet si një mjedis që të të sjellë në mendje dhe antikitetin si dhe të zbukurohet me objekte të arkeologjisë lokale.
Pikat panoramike të qytetit duhet të jenë të studiuara dhe të arritshme nëpërmjet rrjetit rrugor. Rreth e qark qytetit, mbi majat e maleve dhe kodrave, shikohet një pamje magjepsëse e pozicionit qytet-liqen.
Qyteti ka një kala, e cila, për fat të keq, është në mëshirë të fatit dhe e kërcënuar nga ndërtimet.
Si një vlerë e rrallë natyrore dhe kulturore, pa të cilën nuk e kuptojmë Pogradecin, është vija ndarëse e liqenit me bregun e tij.
Qytetet, pra dhe qyteti ynë, janë, më shumë se kurrë, aktorët e shteteve dhe shihen si mekanizma të ekonomisë së tyre kombëtare, shtetet bazohen në zhvillimin e qyteteve të tyre. Në 20 vitet e fundit, qytete e kanë parë fokusin kulturor si një element vital të rigjallërimit dhe qëndrueshmërisë, sensit të tyre të identifikimit, madje të mbijetesës së tyre.





Planimetria e qendres së qytetit
Miratuar nga KRRTRSH, 2005



# Analiza e problemeve mjedisore



## Urbanistika - Infrastruktura mjedisore

| Problemi | Shkaku | Shkalla e ndikimit | Popullsia që preket | Pasojat | Prioritarizmi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Infrastruktura inxhinierike, uji i pijshëm, kanalizimet, ujrat e bardha | Amortizimi i rrjetit<br>Mirëmbajtja jo e mirë;<br>Rritja e popullatës | E lartë | I gjithë qyteti | Ulen vlerat turistike të qytetit;<br>Rritet rreziku për sëmundje infektive;<br>Ulje e mundësisë së popullatës për të pasur ujë të rrjedhshëm, për pasojë duke çuar në higjenë të pakët në shtëpi, e kudo. | * * * |
| 2. Mungesa e zonave të reja të studiuara urbanistike për përspektivën e afërt dhe të largët | Mungesa e planit rregullues të qytetit | E lartë | 50% | Zhvillim i pakontrolluar urbanisitk, duke çuar për pasojë në çrregullime mjedisore, të lidhura me turizmin dhe shëndetin | * * * |
| 3. Ndërhyrjet e paligjshme me ndërtime në zona jo të studjuara urbanistike | Nevoja e popullsisë për strehim;<br>Mundësia për të përfituar nga situata jo e rregullt. | E lartë | 60%. | Zhvillim i pakontrolluar urbanisitk, duke çuar për pasojë në çrregullime mjedisore, të lidhura me turizmin dhe shëndetin | * * * |
| 4. Mungesa e zonave të reja të zhvillimit të qytetit<br><br>Rikthimi i ish zonës industriale në zonë banimi së pari me studim të detajuar urbanistik | Tendencat e shtrirjes së banimit në atë zonë | E lartë | 20% | Ndikimet negative në respektimin e normave dhe standarteve të urbanistikës për urbanizimin e kësaj zonë | * * |
| 5. Mungesa e studimeve në zona të caktuara të qytetit<br><br>Përcaktimi studimi dhe risjellja në gjendje urbanistike e arkitektonike të traditës , të një pjese të qytetit të vjetër si:<br>-Rruga Naim Frashëri<br>-Rruga “11 Janari”<br>-Rruga “24 Maji”<br>-Rruga e Burimave ,etj | Mungesa e përcaktimir të zonës historike të qytetit me një studim të detajuar urbanistik dhe arkitektonik | E lartë | 40% | Zhvillim i pakontrolluar urbanisitk, duke çuar për pasojë në çrregullime mjedisore, të lidhura me turizmin, shëndetin dhe vlerat historike të qytetit | * * * |
| 6. Mungesa e zonave sportive dhe argëtuese në përshtatje me prespektivën e zhvillimit të turizmit elitar. | Mos respektimi i standarteve për zhvillimin e turizmit | E mesme | 20% | Ulje e vlerave shplodhëse dhe rigjeneruese në qytet, duke çuar për pasojë në rënie të vlerave turistike | * |



| Urbanistika - Kanalizimet e ujrave | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Problemi** | **Shkaku** | **Shkalla e ndikimit** | **Popullsia që preket** | **Pasojat** | **Prioritarizmi** |
| 7. Ndotja e ujit të pijshëm nga ujrat e zeza. | -Amortizimi<br>-Afërsia e tubacioneve të ujrave të bardha me ujrat e zeza.<br>-Infrastruktura jo e rregullt e vendosjes së rrjeteve.<br>-Funksionojnë në gjendje mbingarkese. | E ulët | I gjithë qyteti | Sëmundje infektive<br>Prishje e cilësisë së mjedisit<br>Ul vlerat turistike të zonës | * * * |
| 8. Derdhja e ujrave të zeza nëpër mjediset publike. | -Amortizimi i rrjetit.<br>-Mungesa e infrastruktures. | E ulët | I gjithë qyteti | Sëmundje infektive<br>Prishje e cilësisë së mjedisit<br>Ul vlerat turistike të zonës | * * |
| 9. Mostrajtimi i ujërave të zeza. | -Mungesa e impiantit perpunues.<br>-Mungesa e rrjetave infiltruese.<br>-Mungesa e fondeve të nevojshme për mirëmbajtje dhe për investime të reja. | E lartë | I gjithë qyteti | Ul vlerat turistike të zonës<br>Dëmton zonën përreth, sidmos Liqenin e Ohrit, duke ndikuar mbi florën, faunën dhe cilësinë e ujrave në këtë liqen<br>Shkaktohen sëmundje infektive | * * * |
| 10. Bllokimi i kanalizimeve | -Amortizimi<br>-Mbingarkesa nga reshjet e shumta.<br>-Vendosja për efiçente e rrjetit nëntokësor të ujrave të zeza. | Sezonal | I gjithë qyteti | Dalje e ujrave në sipërfaqe<br>Sëmundje infektive<br>Prishje e cilësisë së mjedisit<br>Ul vlerat turistike të zonës | * |
| 11. Ndërhyrjet në rrjetin kryesor të kanalizimeve | -Mungesa e infrastrukturës. | Periferia | I gjithë qyteti | Dëmtim i rrjetit të kanalizimeve, duke çuar për pasojë në humbje të sasië së ujit dhe mos furnizimin e populates<br>Prishje e vlerave turistike, largim i turistëve | * |
| 12. Mungesa e furnizimit me ujë të qytetarëve për 24 orë. | -Humbjet gjatë rrjetit.<br>-Shpërdorimi i ujit nga konsumatorët (lavazhet, ujitjet) nga gjithë qyteti. | E lartë | I gjithë qyteti | Ul vlerat turistike duke larguar turistët | * * * |

| Sipërfaqet e gjelbërta | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Problemet** | **Shkaku** | **Shkalla e ndikimit** | **Popullsia që preket** | **Pasojat** | **Prioritarizimi** |
| 1. Mungesa e sipërfaqeve të gjelbëruara në brendësi të qytetit, blloqeve midis pallateve, etj. | Zënia e sipërfaqeve të gjelbëra me ndërtime dhe kioska shtesa, rrrethina, garazhe etj. | 30% | 12 000<br>banorët e banesave kolektive | Alergji në forma të ndryshme | * * * |
| 2. Dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbërta në parkun "! Maji" dhe lulishtet ekzistuese. | Mbi popullimi i plazhit nga turistët (Korçës, Elbasanit, periferisë së qytetit të Pogradecit etj)<br>Mungesa e banjove publike | 20% | 23 000-25 000 (kryesisht turistë dhe frekuentuesit e plazhit) | Sëmundje të ndryshme të lëkurës me origjinë bakteriale<br>Sëmundje me origjinë patologjike | * * |
| 3. Dëmtimi i drurëve dekorativë. | Degradimi si rrjedhojë e kalimit të moshës së drurëve (shelgjet, plepat)<br>Zëvendësimi i cedres, tijës me drurë dekorativë në gjelbërim gjithëvjetor si pisha, bredh etj. | 2-5% | 10 000 (kalimtarët pensionistët, fëmijët etj). | Alergjitë e ndryshme.<br>Problemet më të dëgjuara pasi drurët ulin përqindjen e zhurmave në mjedise e ndryshme të qytetit. | * |
| 4. Dëmtimi i fidanëve të rinj | Dëmtime të ndyshme nga njerëzit, karrocat, mjetet, fëmijët, banorët etj. | 2-5% | 7000 | Alergji të ndryshme | * |
| 5. Mungesa e masave rehabilituese të ligustrave, shtimit të sipërfaqeve të bordurave me ligustra anës trotuareve të shëtitoreve dhe rrugëve kryesore | Mbrojtja e sipërfaqeve të gjelbra (kryesisht të mbjella me bar) nga shkeljet e këmbësorëve , karrocave etj. | 5-10% | 3000 | Estetike<br>Alergjike<br>Shpenzime të paparshikuara | * |
| 6. Mosfunksionimi me kapacitet të plotë i serës së ndërmarrjes së gjelbërimit në qytetin e Pogradecit | Probleme pronësie<br>Ndërtime pa leje në truallin e sërës së qytetit<br>Sipërfaqja e vogël e serës | 5-7% | E ulët<br>500 | ------ | * |





| Ajri | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Problemi** | **Shkaku** | **Shkalla e ndikimit** | **Popullsia që preket** | **Pasojat** | **Prioritarizimi** |
| 1. Ndotja e ajrit nga tymrat | Transporti automobilistik<br>Tymi i zjarreve që ndizen në shtëpi<br>Veprimtaria e kaldajave<br>Industria ushimore e lehtë | E mesme | E gjithë popullsia e qytetit, si dhe fshatrat përreth | Fenomene alergjike<br>Infeksione të rrugëve të frymëmarrjes<br>Sëmundje të tjera pulmonare | * * |
| 2. Ndtoja e ajrit nga mbeturinat urbane dhe të ngurta | Hedhja e mbeturinave jashtë pikave të grumbullimit<br>Mungesa e fushës së mbeturinave dhe hedhja e tyre në vende të papërshtashme.<br>Mungesa e një fushe sanitare grumbullimi<br>Djegja e mbetjeve | E lartë | 50% e popullsisë | Sëmundje që transmetohen nga kafshët<br>Dizanteri, tifo, hepatit, etj<br>Infeksione të lëkurës | * * |
| 3. Aktiviteti urban | Numri i madh i ndërtimeve të banesave gjatë periudhës së fundit | E lartë | E gjitha popullsia e qytetit | Rritja e ngarkesës së ajrit me grimca pluhuri dhe elementësh të tjerë volativë | * * |
| 4. Aktiviteti i biznesit | Punishtet e vogla të artizanatit që punojnë me bojra kimike<br>Punishtet e drurit që punojnë afër zonës së banuar | E mesme | E gjitha popullsia e qytetit | Shpërndarja e lëndëve kimike në ajër<br>Rritje e saisë së pluhurit në ajër (tallash) | * |
| 5. Aktiviteti jashtë qytetit me ndikim në të | Guroret për prodhojnë lëndë ndërtimi | E ulët | E gjitha popullsia e qytetit | Rritje e ngarkesës së ajrit me lëndë volative të dëmshme | * |

**Turizmi**

| Problemi | Shkaku | Shkalla e ndikimit | Popullsia që preket | Pasojat | Prioritarizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Mungesa e turizmit interaktiv të plotë, me mungesë të: infrastrukturës rrugore; transportit urban e interurban; shërbimit taksi; anijeve turistike tip jahtesh në liqen si dhe mjete të tjera lundruese në ujë | • Mungesa e marketingut në ndërtimin e anijeve<br>• Mungesa e biznesit apo shoqërive turistike me investime në sensin e duhur të kohës. | E mesme | 60 % | Ulje e interesit turistik të zonës;<br><br>Ulen mundësitë për përfitime ekonomike të qytetit dhe për rrjedhojë mbrojtës së pasurive turistike | * * |
| 2. Mungesa e mjediseve të argëtimit për të rinjtë dhe të gjithë të moshuarit; Muzeve të ndryshëm, Qendrave kulturore artistike etj. | Mungesa e mjediseve për kohën e lirë të të rinjve, turistëve, etj.Nuk ka investime për muzetë apo të një kompleksi të mbyllur të pishinave | E mesme | 60% | Ulje e interesit turistik të zonës | * * * |
| 3. Mbipopullimi<br>Lëvizja e lirë e njerëzve ka mbipopulluar Pogradecin me popullsi nga zonat rurale. | Nëpërmjet zbritjeve të pakontrolluara në qytet nëpërmjet ndërtimit pa leje është dëmtuar arkitektura e qytetit dhe qytetit i janë ulur vlerat turistike, mjedisore, artistike si dhe e mbingarkuar me papastërti. | E lartë | 100% | Zhvillim i pakontrolluar urbanisitk, duke çuar për pasojë në çrregullime mjedisore,<br>të lidhura me turizmin dhe shëndetin | * * * |
| 4. Mungesa e zyrave për informacionin turistik sipas kërkesave të kohës. | Mungesa e alternativave për turizmin në Pogradec nëpërmjet guidave turistike, kampingjet etj. | E mesme | 30% | Ul vlerat turistike të qytetit; mundësitë për thithjen e turistëve | * * |
| 5. Mos funksionimi si duhet i turizmit familjar | Mungesa e ujit (furnizimi me orare të caktuara ), energjia elektrike, mungesa e akomodimit sipas kërkesave të kohës, tergu vazhdon të jetë me i shtrenjti në rajon | E lartë | 40% | Ul vlerat turistike të qytetit; mundësitë për thithjen e turistëve | * * * |
| 6. Mungesa e kulturës së shërbimit | Mungesa e kuadrit të nevojshëm për të përballuar fluksin e turizmit, si industri e rëndësishme për specifikimin e Pogradecit | E lartë | 40% | Ul vlerat turistike të qytetit; mundësitë për thithjen e turistëve | * * |



| Energjia | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Problemi** | **Shkaku** | **Shkalla e ndikimit** | **Popullsia që preket** | **Pasojat** | **Prioritarizimi** |
| 1. Mosaplikimi me ritmet e duhura të politikave strategjike kombëtare në gjetjen dhe përdorimin e burimeve të tjera të energjitikës<br><br>Karritje të përdorimit të gazit për gatim dhe pak përdorim të tij për ngrohje. Përdorim të pakët të energjisë djellore. Ka mos kushtëzim të ndërtimeve me teknologji të lartë termoizoluese sidomos për objektet socila kulturore etj dhe ndërtimet masive si dhe mungesë të ngrohjes të përqëndruar. | Mos zbatimi i një politike të drejtë energjitike. Mungesa e eksperiencës dhe mos kushtëzimi me ndërtime sidomos me ato masive.<br>Me gjithë uljen e çmimit të gazit ky çmim vazhdon të jetë përsëri i lartë si dhe ka mungesë sigurie në përdorimin e tij. Çmimi i lartë i paneleve djellore si dhe mungesa e instalimeve përbëjnë një faktor tjetër për mos shfrytëzimin e kësaj energjie. Negativisht ndikon mos përdorimi i saksioneve për ndërtimet e reja. | E mesme | 100 % | Zhvillimi më tej i një industrie që nuk rrespekton mjedisin;<br>Rritjen e ndotjes jonike në ajër | * * * |
| 2. Rrjeti shpërndarës i T.M 10 kv, kalimi në rrjetin e T.M 22kv<br><br>Përshkrimi<br>Rrjeti shpërndarës i tensionit të mesëm 10 kv si ai ajror dhe kabllor në masën 65-70% i amortizuar. Në një pjesë të tij edhe jashtë kushteve teknike si rezultat i ndërtimeve pa leje. (rrjeti ajror 10 kv në zonë nga ish ndërmarrja ushqimore deri tek ish ndërmarja bujqësore) | Amortizimi i rrjetit të tensionit të mesëm, rritja disa herë e përdorimit të energjisë elektrike në familje gjatë viteve 1990 dhe 2000, rrijta e humjeve teknike.<br><br>Krahas amortizimit të rrjetit e përdorimit të energjisë elektrike ka bërë që humbjet në rrjetin e tensiont të mesëm të jenë shumë më të larta se standartet teknike. | Zvogëlimi i humbjeve në rrjetin e tensionit të mesëm në masën 30-40% | Të gjithë abonentët e KESH-it | Rritje e rrezikut ndaj popullatës | * * * |

**Liqeni i Ohrit**

| Problemi | Shkaqet | Shkalla e ndikimit | Popullsia që preket | Pasojat | Prioritarizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Rënia e saisë së peshkut në liqen<br>Përshkrimi:<br>Në liqen nuk vepron asnjë shoqëri peshkimi, e cila të jetë direkt e kontrolluar nga shteti dhe numri i varkave në liqen vepron mbi kapacitetin dhe këto të fundit përdorin rrjeta shumë të mëdha. Gjithashtu, trysnitë shoqëroro-ekonomike kanë çuar në mbipeshkim të koranit, i cili është dëmtuar më shumë se peshqit e tjerë | Peshkmi pa kriter përgjatë gjithë vitit<br>Shkatërrimi i zonës së kallamishteve<br>Peshkimi gjatë periudhës së çiftëzimit<br>Rritja e kërkesës për peshk nga njerëzit<br>Degradimi i habitateve natyrale të folezimit të peshqve | E lartë | E gjithë zona përrreth | Dëmtim i florës dhe faunës së liqenit<br>Ul vlerat turistike rekreative të liqenit | * * * |
| 2. Ndryshimet e bregut të liqenit, zhdukja e kalllamishteve dhe habitateve të tjera natyrore (zona të tjera të vegjetacionit makrofilik)<br><br>Gjatë brigjeve të liqenit të ohrit dikur ka patur breza të gjatë kallamishtesh, por ato tani kanë ndryshuar shumë nga veprimtaria e banorëve që jetojnë përreth liqenit. | Mbledhja e materialeve nga njerëzit për përdorime të ndryshme, duke çuar në rritjen e shkallës së erozionit<br>Gërmimi dhe nxjerrja e rërës në brigjet e liqenit<br>Zhvillim i zonave për pushim dhe argëtim<br>Veprimtaria minerare dhe mbetjet e ngurta të mbetura prej saj | Mesatare | E gjithë zona | Rënie e florës dhe faunës së liqenit<br>Ul vlerat turistike të zonës | * * * |
| 3. Niveli i ulët i ndërgjegjësimit të publikut kombinuar me përdorimin e paekuilibruar të burimeve ekonomike | Zhvillimi i dobët i ekonomisë së qytetit<br>Inflacioni i lartë<br>Nivel i ulët i popullsisë në njohjen e vlerave të liqenit<br>Mungesa e një edukimi të vazhdueshëm | E mesme | E gjitha | • Shkatërrim i faunës dhe florës së liqenit<br>• Dëmtimi i bregut të liqenit<br>• Rritja e rrezikshmërisë për sëmundje infective | * * * |





| Liqeni i Ohrit | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Problemi** | **Shkaqet** | **Shkalla e ndikimit** | **Popullsia që preket** | **Pasojat** | **Prioritarizimi** |
| 4. Ndotja e liqenit nga mbeturinat minerare rreth liqenit të Ohrit<br><br>Në anën shqiptare gjenden 6 minera dhe 1 fabrikë për pasurimin e mineralit, të gjitha në largësinë 2,5 km nga bregu i liqenit, ndërsa 4 miniera të tjera ndodhen 10 km larg bregut. Minierat e kanë ndotur liqenin nga vetë aktiviteti i tyre duke mobilizuar metalet e xeherorët e kromit, hekur-nikelit dhe qymyrgurit. Nga 6 minierat që janë pranë liqenit kanë mbetur 548,000 m3 mbeturina të ngurta. | Vendoshja e minerave shumë pranë liqenit<br>Shkarkimi i ujrave të ndotura të papërpunuara prej nxjerrjes së xeherorit dhe proceseve të prodhimit<br>Depozitimi i mbetjeve prasnë liqenit<br>Kalimi i përrenjve mespërmes zonave minerare<br>Ndotja e ujrave nëntokësore, të cilët komunikojnë me liqenin | E lartë (në afërsi të minierave)<br>E ulët (në zonën e qytetit) | Të gjithë banorët e zonës | • Dëmtimi i ekosistemit ujor<br>• Ndotja e burimeve lokale të ujrave të pijshëm<br>• Disa nga metalet mund të bioakumulohen, çka përbën rrezik për peshqit, zogjtë dhe potencialisht për njerëzit që i përdorin këto të fundit për ushqim<br>• Metalet toksike dhe ekspozimi afatgjatë ndaj tyre ka çuar në efekte të dëmshme në shëndetin e njerëzve | * * |
| 5. Derdhja e ujrave të zeza të papërpunuar në liqen | Mungesa e fondeve për instalimin e impiantit përkatës<br>Mbingarkesa ene rrejtin e kanalizimeve të ujrave të zeza<br>Mungesa e rrjetave infiltruese<br>Shkarkimi pa kriter në disa pika me rrezik të lartë për shëndetin përgjatë vijës bregliqenore | E lartë | E gjitha popullsia e zonës<br>Turistët | • Rrezikshmëri e lartë për sëmundje infektive<br>• ulje e numrit të turistëve<br>• Dëmtimi i faunës liqenore<br>• Eutrofikimi i liqenit | * * *<br>urgjente |
| 6. Eutrofikimi i liqenit<br>Karakteristikë kryesore e Liqenit të Ohrit është gjendja e tij oligotrofe (përqindja e ulët ushqyese) dhe për pasojë prodhimi i ulët primar i liqenit. Eutrofikimi i ujrave do të thotë rritje e prodhimit primar | Shkarkimi masiv i ujrave të zeza<br>Përdorimi i detergjentëve me përbërje të lartë fosfori<br>Shpërlarja dhe erozioni i tokës në zona të veçanta<br>Depozitimet atmosferike në sipqrfaqen e liqenit | E lartë | Të gjithë banorët | Dëmtimi i faunës dhe florës së liqenit<br>Ulje e cilësive turistike të liqenit | * * * |

**Trashegimia kulturore**

| Problemi | Shkaku | Pasojat | Prioritarizimi |
|---|---|---|---|
| 1. Mungesa e sistemit muzeal në qytet, të sanjë lloji si historik, kulturor, artisitik etj. | Rrënimi i disa institucioneve muzeale për shkak të ndryshimeve të pakontrolluara në qytet dhe mungesës së mbrojtjes . | Shumë negativ për imazhin turistiko-kulturor të qytetit i cili pretendon shumë se ka kulturë dhe traditë dhe se ka prioritet absolut në turizimin vendas dhe të huaj | * * * |
| 2. Mungesa e një angazhimi për ruajtjen e trashëgimnisë në fushën e banesave karakteristike dhe lagjeve me vlera qytetare dhe historike | Mungesa e një ligji lokal për ruajtjen nga ndërhyrjet e pakontrolluara në zonat e vjetra me tradita. | Humbja e fizionomisë së qytetit.<br>Denatyralizimi i shpejtë i qytetit në një zonë thjesgt urbane vetëm në sensin urban.<br>Kufizimi i turizmit dhe shkatërimi i pejsazhit kulturor. | * * * |
| 3. Mungesa e një angazhimi për zbukurimin e qytetit nëpërmjet kulturës dhe artit, që ka çuar në:<br>• Shkatërimin e pejzazhit natyror nga ndërtimet.<br>• Kaotizimin në prezantimin e simboleve kulturore dhe historike të qytetit.<br>• Pamjen e shëmtuar e qytetit shprehur me mungesë e harmonisë së kulturave | Mungesa e një pozite kulturore nga mungesa e një forumi kulturor qytetar<br>Mungesa e zbatimit të një kodi dhe etike qytetare. | Thellimi më tej i ndarjes së qytetit prej kulturës së tij. | * * |
| 4. Mosfunksionimi harmonik i qytetit në të gjithë shtrirjen e tij edhe nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve prezente. | Mungesa e një administrimit në nivelin e duhur të disa pikave të rëndësishme si: hyrja e qytetit prej Tirane, konkretisht ura në hyrje të qytetit, shkatërrimi i zonës qendrore të qytetit nga mos funksionimi i dy godinave private në derdhje të lumit etj.<br>Mosvazhdimi i parkut buzë liqenit.<br>Keqpërdorimi i lumit të qytetit vetëm si vend ku mund të hidhen mbeturinat.<br>Mos shpallja nga bashkia enjë zone publike paralel me lumin e qytetit deri në thellësinë e maleve. | Rritja e cilësisë së jetës dhe thellimi i partikularizmit qytetar, degradimi i një zone që ndërpret jetën veçanërisht atë kulturore etj | * * |






# Plani i Veprimit në Mjedis

**Urbanistika**

| Problemi | Aktivitetet | Prioriteti<br>Afati kohor | Organet përgjegjëse dhe partnerët e mundshëm | Kostoja (në Euro) | Efekti |
|---|---|---|---|---|---|
